

№. 1320 D. 19.05.2017

MITROVICA MITROVICA



**Pasqyrat e Ndara Financiare dhe Raporti i Auditorëve të pavarur  
31 Dhjetor 2016 për**

**Trepça – Pjesa e administruar ne Jug te Mitrovicës**

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur.....	3
Bilanci i Gjendjes.....	8
Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve.....	9
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë.....	10
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet.....	11
Shënimet e pasqyrave financiare.....	12

## **RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

Drejtuar: Menaxhmentit dhe Aksionarët e njësisë jugore të “Trepça”-Ndërmarrje nën administrim të AKP-së

### **Raport mbi Pasqyrat Financiare**

#### **Mohim i Opnionit**

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar pasqyrat financiare të ndara të bashkëngjitura të Trepça për njësinë e Ndërmarrjes të Administruar në Jug të Mitrovicës (në vijim referuar si “Kompania” apo Trepça Jug) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2016, pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Ne nuk shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare përcjellëse të kompanisë. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të trajtuara në seksionin Bazat për Mohim të Opnionit të raportit tonë, ne nuk kemi qenë në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi të përshtatshme për të siguruar një bazë për një opinion të auditimit për këto pasqyrat financiare.

#### **Baza për mohim të opnionit**

1. Siç është shpalosur më tej në Shënimin 3 të pasqyrave financiare përcjellëse, më 31 Dhjetor 2016 përfshirë në totalin e pronës, Impianteve dhe Pajimeve të Kompanisë, vlera e asetëve është 12,646,035 euro (31 Dhjetor 2015; 13,279,022 euro). Duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që mban organizata, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse neto të Pronës, Impianteve dhe pajimeve të kompanisë më 31 Dhjetor 2016. Po ashtu kompania nuk ka një metode konsistenete në lidhje me kapitalizimin e shpenzimeve dhe zhvlerësimin e tyre.
2. Siç paraqitet në shënimin 4 të pasqyrave individuale financiare, vlera e inventarëve të Kompanisë më 31 dhjetor 2016 është 1,164,258 (31 Dhjetor 2015; 1,580,339 euro). Ne jemi emëruar si auditor pas fundit të vitit dhe nuk kemi marrë pjesë në numërimin fizik të materialeve të para dhe stoqeve të Kompanisë më 31 dhjetor 2016. Ne nuk ishim në gjendje të fitonim siguri të arsyeshme me procedura alternative në lidhje me sasinë e inventarit gjendje më 31 dhjetor 2016, si rezultat, nuk jemi në gjendje të përcaktojmë shumën e ndonjë korrigjimi të mundshëm në lidhje inventarët e

Kompanisë më 31 dhjetor 2016 dhe efektet që do të kishte në pasqyrën individuale të të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016.

Per me tepër, gjate auditimit ton ne kemi verejtur qe stoqet ne Kontabilitet nuk udhëhiqen në menyre konsitetnte, saldo e stoqeve regjistrohesh vetem me numerim te fundvitit perderisa gjate tere vitit nuk regjistrohen fletedaljet, po ashtu kompania nuk ka kryer ndonje vleresim per demtin te vleres se stoqeve dhe nuk ka njohur ndonje provizion per stoqe te vjetruara, prandaj ne prape nuk ishim ne gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative te auditimit, te përcaktojmë vlerën e stoqeve me 31 Dhjetor 2016. Po ashtu kompania ka kryer një vlerësim te vlerës se stoqeve duke rritur vlerën e tyre, ne nuk ishim ne gjendje duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative te auditimit, te përcaktojmë nëse ky vlerësim është kryer ne përputhje me Standardet Ndërkombëtare te Raportimit Financiar.

3. Siç është shpalosur më tej në Shënimin 5 të pasqyrave financiare përcjellëse, më 31 Dhjetor 2016 përfshirë në totalin e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera të Kompanisë, bilanci i të arkëtueshmeve tregtare është 4,490,302 euro (31 Dhjetor 2015; 2,878,522 euro). Ne mungese te konfirmimeve nga blerësit dhe duke pasur parasysh qe nje pjese e konsiderueshme e ketyre llogarive jane te vjetruara dhe Kompania nuk ka njohur ndonje provizion per borxhe te kqija, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse neto të të arkëtueshmeve tregtare të kompanisë më 31 Dhjetor 2016.
4. Siç është shpalosur në shënimin 8 të pasqyrave financiare shoqëruese, bilanci i detyrimeve afatgjata te Kompanisë më 31 dhjetor 2016 arrin shumën në 3,964,313 euro (31 Dhjetor 2015; 2,705,767 euro) . Ne mungese te konfirmimeve nga furnitorët dhe duke pasur parasysh natyren e sheimeve qe mban Kompania, ne nuk ishim në gjendje të sigurohemi rreth vlefshmërisë dhe plotësisë së detyrimeve afatgjata të kompanisë 31 dhjetor 2016.
5. Siç është shpalosur në shënimin 9 të pasqyrave financiare shoqëruese, bilanci i të pagushmeve tregtare dhe të tjera më 31 dhjetor 2016 arrin shumën në 4,499,514 euro (31 Dhjetor 2015; 4,340,969 euro) . Ne mungese te konfirmimeve nga furnitorët dhe duke pasur parasysh natyren e sheimeve qe mban Kompania, ne nuk ishim në gjendje të sigurohemi rreth vlefshmërisë dhe plotësisë së të pagushmeve tregtare dhe të tjera më 31 dhjetor 2016.
6. Kompania nuk ka njohur ndonjë aset apo detyrim te tatimit te shtyrë dhe në të njëjtën kohë as shpenzim apo fitim te tatimit të shtyrë në pasqyrat e saj financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016 ashtu siç kërkohet me Standardin Ndërkombëtar te Kontabilitetit numer 12 "Tatimet ne te Ardhura". Ne mungese te procedurave alternative te auditimit ne nuk ishim ne gjendje te percaktojm nivelin e korrigjimeve, nese do kishte pasur, te cilat do te kishin qene te nevojshme me qellim te regjistrimit

te tatimeve ne përputhje me Standardin Ndërkombëtar te Kontabilitetit numer 12 "Tatimet ne te Ardhura".

7. Kompanisë i mungojnë të dhënat adekuate të kontabilitetit në lidhje me dhënien e informacioneve të kërkuara nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për pasqyrat financiare në veçanti në lidhje me instrumentet financiare dhe shpalosjet tjera ne lidhje me prodhimin dhe kapacitetet e shitjes, për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016. Si rezultat i kësaj ne nuk ishin në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit për dhënien e informacioneve shpjeguese të tilla të kërkuara nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016. Si pasojë, ne nuk ishin në gjendje për të përcaktuar nëse ndonjë rregullim i këtyre shpalosjeve do të ishte i nevojshëm.
8. Gjatë auditmit ton ne kemi vërejtur se ndaj Kompanisë janë ushtruar disa padi. Kompania nuk ka njohur ndonjë provizion për rastet gjy qësore për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 ashtu siç kërkohet me Standardet Ndërkombëtare te Raportimit Financiar prandaj nenuk ishim ne gjendje te vleresoni nese ndonje rregullim eshte i nevojshem per tu bere ne pasqyrat financiare percjellëse.

#### **Çështjet e theksuara**

Duke mos e kualifikuar me tutjë mendim tone, ne tërheqim vëmendjen si më poshtë:

- i) Siç është shpalosur në shënimin 16 të pasqyrave financiare përcjellëse, librat dhe regjistrimet tatimore të Kompanisë nuk janë audituar nga Autoriteti tatimor për vitin që përfundon që 31 Dhjetor 2016 dhe 2015. Si rrjedhojë e kësaj, detyrimet tatimore të Kompanisë nuk mund të konsiderohen të finalizuara. Provizionet për taksat shtesë dhe gjobat, nëse ka ndonjë, nuk mund të përcaktohen me ndonjë saktësi të arsyeshme, në këtë fazë.
- ii) Siç është shpalosur në shënimin 1 të pasqyrave te ndara financiare përcjellëse, këto pasqyra financiare prezantojnë vetëm pozicionin financiar te njesisë së Trepçes e cila administrohet ne Jug te Mitrovicës dhe jo të Ndermarrjes Trepça ne tërësi.
- iii) Ndërmarrja Tepça është ne procec te ristrukturimit dhe të kalimit nga Ndërmarrje nën administrimin e Agjensionit Kosovar te Privatizimit në Ndermarrje Publike, statuti perfundimtar i Trepçës akoma nuk eshte definuar.

Opinionin jonë nuk është modifikuar në lidhje me çështjet e detajuara në paragrafin i deri ne iii më sipër.



## **Çështjet kryesore të auditimit**

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje janë trajtuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tone më sipër, dhe ne nuk do të japin një opinion të veçantë mbi këto çështje.

## **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likujdojë Kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

## **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që

përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për

qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.


Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arsye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet në favor të interes publik.

18 Maj 2017

Audit&Conto sh.p.k


  
Ymer Shatri  
Partner Angazhimi



## Pasqyra e Pozitës Financiare

	Shenim	Me 31 Dhjetor	
		2016	2015
<b>Asetet</b>			
<b>Asetet joqarkulluese</b>			
Prona ,impiantet dhe paisjet tjera	3	12,646,035	13,279,022
		<u>12,646,035</u>	<u>13,279,022</u>
<b>Asetet qarkulluese</b>			
Stoqet	4	1,164,258	1,580,339
Llogarit e arktueshme dhe kerkesa tjera	5	4,490,302	2,878,522
Paraja dhe ekuivalentet e paras	6	2,209,159	949,514
		<u>7,863,719</u>	<u>5,408,375</u>
<b>Total asetet</b>		<u><u>20,509,754</u></u>	<u><u>18,687,397</u></u>
<b>Ekuiteti</b>			
Kapitali dhe rezervat		22,808,174	22,808,174
Fitimet e mbajtura	7	(12,692,073)	(7,931,623)
Fitimi I vitit		650,510	(4,760,450)
<b>Total ekuiteti</b>		<u>10,766,611</u>	<u>10,116,101</u>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet joqarkulluese</b>			
Detyrime afatgjata	8	3,964,313	2,705,767
<b>Total detyrimet joqarkulluese</b>		<u>3,964,313</u>	<u>2,705,767</u>
<b>Detyrimet qarkulluese</b>			
Llogarit e pagueshme dhe detyrime tjera	9	4,499,514	4,340,969
Detyrimet ndaj te punësuarve	10	1,148,093	1,503,713
Obligimet tjera		131,223	20,847
<b>Total detyrimet qarkulluese</b>		<u>5,778,829</u>	<u>5,865,529</u>
<b>Total detyrimet</b>		<u>9,743,143</u>	<u>8,571,296</u>
<b>Total detyrimet dhe ekuiteti</b>		<u><u>20,509,754</u></u>	<u><u>18,687,397</u></u>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i Kompanisë më 31 Mars 2017 dhe nënshkruar nga:

  
Z. Hysni Sadiku  
Drejtor financiar

  
Z. Ahmet Ilmava  
Drejtor Menaxhues



## Pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse

	Shënimi	Për vitin që përfundon me	
		2016	31 Dhjetor 2015
<b>Të hyrat operative</b>			
Te hyrat nga shitja	11	14,671,045	8,402,066
Te hyrat tjera	12	389,599	1,041,927
<b>Bruto fitimi</b>		<b>15,060,644</b>	<b>9,443,993</b>
<b>Shpenzimet) operative</b>			
Paga për punëtor	13	(10,822,219)	(10,893,014)
Shpenzimet e materialit dhe lëndës së parë		(4,470,612)	(3,921,729)
Shpenzimet e zhvlerësimit	3	(835,214)	(851,806)
Shpenzimet tjera operative	14	(1,355,519)	(1,386,681)
Shpenzimet tjera afariste		(196,137)	(372,109)
Provizioni për llogari të arketueshme		(4,924)	
<b>Total shpenzimet</b>		<b>(17,684,624)</b>	<b>(17,425,339)</b>
<b>Fitimi operativ</b>		<b>(2,623,980)</b>	<b>(7,981,346)</b>
<b>Të ardhurat financiare</b>			
Shpenzimet financiare	15	3,333,522	3,249,553
		(59,033)	(28,657)
<b>Fitimi / (Humbja) para tatimit</b>		<b>650,510</b>	<b>(4,760,450)</b>
Tatimi në fitim	16		
<b>(Humbja)/Fitimi i vitit</b>		<b>650,510</b>	<b>(4,760,450)</b>
<b>Te hyrat tjera gjithëpërfshirëse neto nga tatimet</b>			
<b>Total te hyrat gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>650,510</b>	<b>(4,760,450)</b>

## Pasqyra e rrjedhës së parasë

	Viti që përfundon me 31	
	2016	Dhjetor 2015
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi / (humbja) i / e vitit	650,510	(4,760,450)
<i>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</i>		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	835,214	851,806
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme		
Shpenzimet e tatimit në fitim		
	1,485,723	(3,908,644)
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(1,611,780)	1,389,999
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	416,081	541,863
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	(86,699)	1,740,014
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>	<b>203,325</b>	<b>(236,768)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(202,227)	(911,665)
Dividendat e arkëtuara		
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese</b>	<b>(202,227)</b>	<b>(911,665)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Ndryshimi në detyrimet afatgjata	1,258,546	294,625
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>	<b>1,258,546</b>	<b>294,625</b>
<b>Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë</b>	<b>1,259,645</b>	<b>(853,808)</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	949,514	1,803,322
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>	<b>2,209,159</b>	<b>949,514</b>

## Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

	Kapitali dhe rezervat	Fitimet (Humbjet) e akumuluar	Totali
Me 01 Janar, 2015	16,819,743	(7,931,623)	8,888,120
Fitimi /Humbja e vitit		(4,760,450)	(4,760,450)
Rivleresimi i rezervave	5,988,431		5,988,431
<b>Me 31 Dhjetor, 2015</b>	<b>22,808,174</b>	<b>(12,692,073)</b>	<b>10,116,101</b>
Me 01 Janar, 2016	22,808,174	(12,692,073)	10,116,101
Fitimi /Humbja e vitit		650,510	650,510
Terheqje e dividendes			
<b>Me 31 Dhjetor, 2016</b>	<b>22,808,174</b>	<b>(12,041,563)</b>	<b>10,766,611</b>

**Trepça – Njësia e administruar ne pjesën Jugore të Mitrovicës  
Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin qe përfundon me 31 Dhjetor 2016**

## **1. Të Përgjithshme**

Trepça – Ndërmarrje në Administrim të AKP-se prej datës 8 Nëntor 2011 për të gjitha veprimet procedurat që kanë për qëllim përcaktimin e vlefshmërisë zbatimin apo përmbushjen e kërkesave apo interesave të pasurisë mund të procedohen vetëm me lejen e dhomes së posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Që nga data 8 Nëntor 2011 Agjencia Kosovare e Privatizimit do të shërbejë si administratore e ndërmarrjeve Trepça.

Keto pasqyra financiare janë të përgatitura vetëm për pjesën Jugore të Trepçës, të gjitha politikat, shpalosjet dhe të tjera janë vetëm për pjesën Jugore të Trepçës – Ndërmarrje në Administrimin e AKP-se.

Ndërmarrja është themeluar më 3 Shkurt 2006 si Ndërmarrje shoqërore. Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes janë: prodhimi i makinave për minierë, prodhimi i akumulatoreve të stacioneve dhe baterive elektrike, riciklimi i mbeturinave dhe hedhurinave metalike, nxjerrja e mineraleve të metalit, prodhimi i metaleve të çmuara, tregtia me shumicë e metaleve e xeheve etj.

Numri i punetoreve më 31 Dhjetor 2016 është 1392 punonjës të rregullt aktiv.

Trepça njësi në jug të Mitrovicës operon plotësisht e ndarë nga njësi veriore e saj në praktikë, përderisa të dyja njësitë janë të regjistruara si një biznes i vetëm.

Ky raport financiar prezanton pozitën financiare dhe transaksionet e ndodhura gjatë vitit vetëm për njësinë e Trepçës në jug të Mitrovicës dhe jo të Trepçës në tërësi.

Bazuar në vendimin e qeverisë, ndërmarrja Trepça është në proces të ristrukturimit dhe të kalimit nga Ndërmarrje në administrimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit në Ndërmarrje Publike, statuti përfundimtar i Trepçës akoma nuk është definuar.

## **2. Politikat e kontabilitetit**

Në vijim janë politikat themelore të kontabilitetit të adoptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

### **2.1 Bazat e përgatitjes**

Këto pasqyra janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë përgatitur nën marrëveshjen e kostos historike, ndërsa e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve në shumat e rivlerësuara sikurse janë të përshkruara tutje në këtë shënim.

Këto pasqyra janë përgatitur nën pohimin se Kompania do të vazhdojë vijueshmërinë e saj se paku në 12 muajt e ardhshëm.

Operacionet e Kompanisë janë të varura dhe të mbështetura nga grante me fonde të ndryshme. Menaxhmenti i konsideron të mjaftueshme fondet e jashtme që do të jenë të mundshme në të ardhmen të cilat do të mundësojnë Kompanisë pagesën e borxheve të tyre me kohë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me IFRS-të kërkon nga menaxhmenti të bëjë vlerësimet dhe parashikimet të cilat ndikojnë në shumat e raportuara të asetëve dhe detyrimeve dhe shpalosjet e pasurive dhe detyrimeve kontingjente në datën e pasqyrës financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë periudhës së raportuar. Këto vlerësime janë bazuar në informatat e disponueshme në datën e pasqyrave financiare. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016. Të gjitha të dhënat janë të shfaqura në euro vetëm nëse nuk qëndron ndryshe.

### **2.1 Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedha të huaja fillimisht regjistrohen në monedhën aktuale pastaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksioneve. Vlerat e Aseteve dhe detyrimeve në monedha të huaja janë konvertuar duke përdorur kursin e këmbimit në datat e bilancit të gjendjes. Fitimet dhe humbjet e ndodhura nga shkëmbimet valutore paraqiten në pasqyrën e të Ardhurave dhe shpenzimeve.

## **2.Politikat e kontabilitetit (vazhdim)**

### **2.2 Prona, Impiantet dhe pajimet**

Zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve ekzistuese te blera-furnizuara apo ndertuara pas vitit 2001 jane paraqitur sipas koston se blerjes se tyre, minus zhvlerësimi i akumuluar pasues. E gjithë prona, impiantet dhe paisjet tjera janë paraqitur sipas koston zbritur për zhvlerësimin e akumuluar. Kosto paraqet shpenzimet që i atribuohen direkt përvetësimit të njësive (zërave). Kostot pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të aseteve apo janë njohur si asete te veçanta, siç ka qene me e përshtatshme, vetëm atëherë kur përfitime ekonomike të mundshme lidhur më këtë mund të rrjedhin në Kompani dhe kostoja e mjetit mund të matet besueshëm. Të gjitha kostot tjera për riparime dhe mirëmbajtje ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur. Toka nuk është e zhvlerësuar. Zhvlerësimi në pasuritë tjera është bërë me metodën drejtvizore për të alokuar kostot e tyre ose shumat e rivlerësuar të vlerave të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar siç vijon:

Ndërtesat	5%
Pajisje montimi dhe makineria	10%
Veturat dhe mjete transportuese	10%
Kompjuterët, Pajisjet e Zyrës,	20%

### **2.3 Dëmet e pasurive jo-financiare**

Pasuritë të cilat kanë jetë përdorimi të padefinuar nuk janë subjekt i zhvlerësimit dhe testohen çdo vit dëmet e tyre. Pasuritë të cilat janë subjekt zhvlerësimi rishikohen për dëmet kurdo që ka indikacione te cilat mund te tregojnë që vlera bartëse e tyre nuk mund te rikuperohet. Humbjet nga dëmet janë njohur ne shumen për te cilën vlera bartëse e asetit e tejkalon vlerën e tij te rikuperueshme. Vlerë e rikuperimit merret me e larta e vlerës fer te shitjes se atij aseti minus kosto për shitjen apo vlera e koston historike. Për qëllime të vlerësimit të dëmeve, pasuritë janë të grupuara në nivelin më të ulët prej nga janë identifikuar ndaras rrjedhat e parasë (gjenerimi i njësive të parasë). Pasuritë jo financiare të cilat janë dëmtuar janë rishikuar për mundësinë e rikthimit të dëmeve në secilën datë raportimi.

### **2.4 Asetet dhe detyrimet financiare**

Asetet dhe detyrimet financiare te prezantuar ne bilancin e gjendjes përfshijnë paranë, ekuivalentet e parasë, llogarite e arkëtueshme dhe detyrimet. Kompania klasifikon instrumentet e saja financiare si asete, detyrime apo ekuitet ne përputhje me substancën e marrëveshjes relevante. Fitimet apo humbjet e interesit te ndërlidhura me instrumentet financiare te klasifikuara si asete, detyrime apo ekuitet janë te prezantuar si te hyra apo shpenzime, respektivisht.

## **2. Politikat e kontabilitetit (vazhdim)**

Blerjet dhe shitjet e mjeteve financiare njihen në datën e tregtimit – data kur Kompania kryen blerjen apo shitjen.

### **2.5 Vlera fer e asetëve dhe detyrimeve kontigjente**

Vlera bartëse e reflektuar në bilancin përcjellës të parasë dhe ekuivalenteve të parasë, të të arkëtueshmeve dhe detyrimeve afatshkurtra përafron vlerën e tyre reale për shkak të maturimit relativisht të shkurtë të këtyre instrumenteve financiare..

### **2.6 Llogarite e arkëtueshme dhe kërkesat tjera**

Të arkëtueshmet tregtare njihen në fillim në vlerën e tyre reale dhe paraprisht të matura me koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit, minus provizionin për dëme. Provizioni për dëmet e të arkëtueshmeve tregtare është vendosur aty ku ka dëshmi të njaftueshme që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledh të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të të arkëtueshmeve. Vështërsit e mëdha financiare të debitorit, me gjasë që debitori të bankrotoj apo të riorganizohet financiarisht, mospagesa apo gabimi në pagesa (që vonohen më shumë se 30 ditë) konsiderohen si indikator që të arkëtueshmet tregtare janë dëmtuar. Shuma e provizionit është diferenca në mes vlerës bartëse të asetëve dhe vlerës prezente të vlerësuar të rrjedhës së parasë së ardhshme, e zbritur në normën origjinale efektive të interesit. Asetet me maturi afatshkurtër nuk janë zvogëluar.

Vlera bartëse e asetëve zvogëlohet përmes përdorimit të një kontoje për lejim, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave në koston e 'shitjeve dhe të marketingut'. Kur një e arkëtueshme tregtare është e pambledhshme, shlyhet kundër kontos për lejimet e të arkëtueshmeve tregtare. Kthimi i pastajshëm i shumave, më parë të shlyera kreditohen kundër 'shpenzimeve tjera operative' në pasqyrën e të ardhurave.

### **2.7 Paraja dhe ekuivalentet e parasë**

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paranë në banka dhe në dorë. Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përbëhet nga paraja dhe ekuivalentet e parasë të definuar si më lartë.

### **2.8 Stoqet**

Vlera e stoqeve paraqet me të ulëtën e koston apo vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi shitës në rrjedha të zakonshme të biznesit, zvogëluar për koston e kompletimit, marketingut dhe shpërndarjes. Kostoja parimisht është përcaktuar në baza të çmimit mesatar.

### **2.9 Kapitali Aksionar**

Marre para sysh situatën në të cilën Trepça gjendet si një kompani me status të padefinuar (as ndërmarrje publike e as ndonjë forme tjetër e organizimit të kompanive në

## 2.Politikat e kontabilitetit (vazhdim)

Kosove) ky kapital ende mbetet i padefinuar deri ne momentin e definimit respektivisht te përcaktimit te formës se saj apo edhe te privatizimit te saj. Rezervat paraqesin ndryshimet ndërmjet kapitalit të regjistruar dhe vlerës neto të aseteve siç është përcaktuar nga vlerësimi i pavarur në datën e inkorporimit të Kompanisë.

### 2.10 Beneficionet e punëtorëve

Trepça kontribuon për punëtorët e saj në planet pas pensionimit si janë të përshkruara nga legjislacioni i sigurimit shoqëror i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Kontributet, bazuar në paga, bëhen tek , Trust i Kursimeve Pensionale Kosovës(TKPK). Nuk ka ndonjë detyrim shtesë lidhur me këto plane dhe këto skema konsiderohen si plan i caktuar i kontributeve. Trepça nuk ka beneficione pas pensionimit për punëtorët e tyre. Veç kësaj, Trepça për ish-punëtorët e saj kontribuon ne formë te pensioneve te parakohshme dhe stipendioneve një forme e ndihmës solidare për punëtorët e mbetur te papune.

### 2.11 Llogarite e pagueshme dhe detyrimet tjera

Të pagueshmet tregtare dhe te tjera njihen në vlerën reale dhe më pas maten me koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit.

### 2.12 Tatimi në fitim rrjedhës dhe i shtyrë

Tatimi në fitim rrjedhës kalkulohejt në bazë të ligjit për tatime në fuqi deri në datën e bilancit të gjendjes.

Tatimi në fitim i shtyrë është parashikuar në tërësi, duke përdorur metodën e detyrimeve, në arritjen e diferencave të përkohshme në mes të bazës së taksave të pasurisë dhe detyrimeve dhe vlerën bartëse të tyre për qëllime të prezantimit në pasqyrat financiare. Tatimi i shtyrë përcaktohet duke përdorur normën e tatimit që është në fuqi deri në datën e bilancit të gjendjes dhe pritet të aplikohet kur pasuria prej tatimit të shtyrë të realizohet apo detyrimi i tatimi të shtyrë është përcaktuar.

Kompania nuk ka njohur asnjë detyrim apo pasuri për tatim të shtyrë më 31 Dhjetor 2015.

### 2.13 Njohja e të hyrave dhe shpenzimeve

Të hyrat njihen kur është mundësia e përfitimeve ekonomike lidhur me rrjedhën e transaksioneve te ndërmarrjes dhe kur shumat e të hyrave mund te matet besueshëm. Te hyrat njihen sipas parimit akruar, ne momentin e fitimit.

Shpenzimet operative njihen ne pasqyrën e të ardhurave në kryerjen e shërbimit ose në datën e origjinës. Shpenzimet njihen sipas parimit akruar, ne momentin e ndodhjes.



## **2.Politikat e kontabilitetit (vazhdim)**

### **2.14 Grantet Qeveritare**

Grantet nga qeveria njihen ne vleren reale kur ka një siguri te arsyeshme që grantet do të mirren dhe Kompania do të përbush kushtet e bashkangjitura.

Grantet qeveritare në lidhje me shpenzime janë të shtyera dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave ne periudhën ne te cilën kane ndodhur shpenzimet për te cilat ka qene i dedikuar granti.

Grantet qeveritare në lidhje me blerjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve janë të përfshira në detyrime jo qarkulluese si grant qeveritar i shtyre dhe janë kredituar ne pasqyrën e të ardhurave në baza drejt-vizore sipër jetës së pritur për pasuritë e lidhura.

### **2.15 Provizionet**

Provizioni njihet kur Kompania ka një obligim të tanishëm si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe mundësia është që një rrjedhje e burimeve të mishëroj beneficionet ekonomike që do të jenë të kërkuara që të shlyhet obligimi dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet në shumën e obligimit.

### **2.16 Detyrimet kontingjente**

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përveç në rastet kur ekziston mundësia qe kompania ne një te ardhme te ketë dalje te aseteve si pasoj e pëmbushjes se detyrimeve. Shuma e humbjeve kontingjente njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë qe, detyrimi ka ndodhur në datën e bilancit të gjendjes dhe munde te behet parashikim i arsyeshëm humbjeve.

### **2.17 Ngjarjet Pasuese**

Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat japin informacione shtesë për pozitën e kompanisë në datën e bilancit të gjendjes (ngjarjet rregulluese) janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat nuk janë ngjarje qe rregullojnë zërat e bilancit te gjendjes për atë date janë shpalosur në shënime ne rastet kur këto shuma janë materiale.

## **2.2 NDRYSHIME NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHPALOSJET**

**Standardet e reja dhe të rishikuara që janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016**

Në vitin aktual, Kompania ka zbatuar një numër të ndryshimeve në SNRF të publikuara nga Bordi i Standardeve Nërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) që janë të obligueshme dhe efektive për periudhën që fillon me ose pas datës 1 janar 2016.

### **Ndryshimet në SNK 1 Iniciativa e shpalosjeve**

Kompania ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet qartësojnë se entiteti nuk ka nevojë të ofrojë shpalosje specifike të kërkuar nga SNRF nëse informata rezultuese nga shpalosja nuk është materiale dhe ofron udhëzime për bazën e agregimit dhe disagregimit të informatave për qëllime të shpalosjes. Mirëpo, ndryshimet ritheksojnë se entiteti duhet të konsideroj ofrimin e shpalosjeve shpesh kur pajtueshmëria me kërkesën specifike në SNRF është e pamjaftueshme për të mundësuar përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë ndikimin e transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve specifike mbi pozitën financiare dhe performancën financiare të entitetit.

Sa i përket strukturës së pasqyrave financiare, ndryshimet ofrojnë shembuj të rradhitjes ose grupimit sistematik të shënimeve.

Zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka rezultuar më ndonjë ndikim në performancën financiare ose pozitën financiare të Organizatës.

### **Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38 Qartësimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit**

Kompania ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet në SNK 16 ndalojnë entitetet të përdorin zhvlerësimin e bazuar në të hyra si metodë të zhvlerësimit për zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve. Ndryshimet në SNK 38 paraqesin supozime të kundërshtueshme se të hyrat nuk janë bazë e duhur për amortizimin e një pasurie të patrupëzuar. Ky supozim mund të kundërshtohet në dy rrethanat e kufizuara në vijim.

- a) Kur pasuria e patrupëzuara është shprehur si masë e të hyrave; ose
- b) Kur mund të demonstron se të hyrat dhe konsumimi i përfitimit ekonomik i pasurisë së patrupëzuar janë në një korelacion të lartë.

Pasi që Kompania tashmë përdor metodën drejtëvizore të zhvlerësimit dhe amortizimit për pasuritë joqarkullore dhe pasuritë e patrupëzuara përkatësisht, zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Organizatës.

### **Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41 Bujqësia: Bimët bartëse**

Kompania ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet përkufizojnë bimët bartëse dhe kërkojnë që pasuritë biologjike që përmbushin përkufizimin e një bime bartëse të trajtohet si pronë, impiant dhe pajisje në pajtueshmëri me SNK 16, në vend të SNK 41. Frytet që rriten në bimët bartëse vazhdojnë të trajtohen në pajtueshmëri me SNK 41.

Zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të organizatës pasi që organizata nuk është përfshirë në aktivitete bujqësore.

## 2.2 NDRYSHIME NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHPALOSJET (Vazhdim)

### Përmirësimet vjetore në Ciklin 2012-2014 të SNRF

Kompania ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Përmirësimet vjetore në ciklin 2012-2014 të SNRF përfshijnë një numër të ndryshimeve në SNRF të ndryshme, të cilat janë përmbledhur më poshtë.

Ndryshimet në SNRF 5 paraqesin udhëzime specifike në SNRF 5 për entitetet që rëklasifikojnë një pasuri (ose grup të shlyerjes) nga ajo që mbahet për shitje në pasuri të mbajtur për shpërndarje të pronarët (ose e kundërta). Ndryshimet qartësojnë se një ndryshim i tillë duhet të konsiderohet si vazhdimësi e planit original të shlyerjes/shitjes prandaj kërkesat e paraqitura në SNRF 5 lidhur me ndryshimin e planit të shitjes nuk zbtohen. Ndryshimet po ashtu qartësojnë udhëzimet se kur ndërpritet kontabilitetit i mbajtjes për shpërndarje.

Ndryshimet në SNRF 7 ofrojnë udhëzime shtesë për të qartësuar nëse një kontratë e shërbimeve është përfshirje e vazhdueshme në një pasuri të transferuar për qëllim të shpalosjeve të kërkuara lidhur me pasuritë e transferuara.

Ndryshimet në SNK 19 qartësojnë se norma e përdorur e skontimit të obligimeve pas-punësimit duhet të përcaktohet duke iu referuar rendimentit të tregut në fund të periudhës së raportimit në bono korporative të cilësisë së lartë. Vlerësimi i thellësisë së tregut për bono të cilësisë së lartë duhet të jetë në nivelin e valutës (dmth në valutën e njëjtë në të cilën do të paguhen përfitimet). Për valutat për të cilat nuk ka treg të thellë në bono të tilla korporative me cilësi të lartë, duhet të përdoret rendimenti i tregut në fund të periudhës raportuese për bonot qeveritare të denominuara në atë valutë.

Zbatimi i këyre ndryshimeve nuk ka pasur efekt në pasqyrat financiare të organizatës.

**Standardet, ndryshimet dhe interpretimet në standardet ekzistuese të cilat nuk janë ende efektive**

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese janë publikuar nga BSNK të cilat nuk janë ende efektive dhe nuk janë adoptuar nga Kompania. Informatat për ndryshimet që pritet të jenë relevante për Kompaninë, janë paraqitur më poshtë.

Menaxhmenti pret se të gjitha publikimet do të adoptohen në politikat kontabël të organizatës për periudhën e parë që fillon pas datës efektive të publikimeve. Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet që nuk janë adoptuar ose nuk janë listuar më poshtë nuk pritet të kenë efekt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

### SNRF 9 Instrumentet financiare

Standardi i ri për instrumentet financiare (SNRF 9) paraqet ndryshime domethënëse në udhëzimet e SNK 39 për rëklasifikimin dhe matjen e pasurive financiare dhe paraqet modelin e ri të 'humbjes së pritit kreditorë' për dëmtimin e pasurive financiare. SNRF 9 po ashtu ofron udhëzime të reja mbi zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.

Menaxhmenti ka filluar të vlerësojë ndikimin e SNRF 9 por nuk është ende në pozitë të ofrojnë informata të kuantifikuara.

SNRF 9 është efektive për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2018.

## 2.2 NDRYSHIME NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHPALOSJET (Vazhdim)

### SNRF 15 Të hyrat nga kontratat me konsumatorët

SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të hyrave, duke zëvendësuar SNK 18 'Të hyrat', SNK 11 'Kontratat ndërtimore' dhe disa interpretime që lidhen me të hyrat. Parimi themelor i SNRF 15 është që entiteti duhet të njoh të hyrat ashtu që ilustron transferin e mallrave ose shërbimeve të premtuara te konsumatorët në shumën që reflekton konsideratën për të cilën entiteti ka të drejtën si shkëmbim për ato mallra ose shërbime.

SNRF 15 është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2018.

### SNRF 16 Lizingu

SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre Interpretime përkatëse. SNRF 16 paraqet model gjithëpërfshirës për identifikimin e arranzhimeve për lizing dhe trajtimin kontabël për qiradhënësit dhe qiramarrësit. SNRF 16 bën dallimin në mes të kontratave për shërbime duke u bazuar në faktin nëse një pasuri e identifikuar kontrollohet nga konsumatori. Dallimet në mes të lizingut operativ (jashtë bilancit) dhe lizingut financiar (në bilanc) janë hequr për kontabilitetin e qiramarrësit dhe është zëvendësuar me modelin sipas të cilit e drejta e përdorimit të pasurisë dhe detyrimi korrespondues duhet të njihen për të gjitha lizingjet nga qiramarrësi (dmth të gjitha në bilanc) përveç për lizingjet afatshkurta dhe lizingjet për pasuritë me vlerë të ulët.

SNRF është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019. Menaxhmenti ende pritet të vlerësojë në tërësi ndikimin e këtij standardi prandaj nuk është në gjendje të ofroj informata të kuantifikuara.

### 3. Prona, impiantet dhe pajisjet

<u>Kosto</u>	Ndertesa dhe rruge	Paisje dhe makineri	Mjete transportuese	Paisjet dhe te tjera	Investimet ne vijim	Totali
Me 01 Janar 2016	821,664	12,707,965	1,100,841	5,314,801		19,945,271
Blerjet gjate vitit		202,226				202,226
Transferimet gjate vitit						0
Shitjet / Huhjet gjate vitit						0
<b>Me 31.12.2016</b>	<b>821,664</b>	<b>12,910,191</b>	<b>1,100,841</b>	<b>5,314,801</b>		<b>20,147,497</b>
<u>Zhvleresimi i Akumuluar</u>						
Me 01 Janar 2016	(77,884)	(5,719,225)	(782,677)	(86,461)		(6,666,247)
Zhvleresimi i vitit	(13,397)	(707,863)	(106,619)	(7,334)		(835,214)
Rregullimet e lidhura me shitje/ huhje						0
<b>Me 31 Dhjetor 2016</b>	<b>(91,281)</b>	<b>(6,427,088)</b>	<b>(889,296)</b>	<b>(93,795)</b>		<b>(7,501,461)</b>
<b>Vlera neto ne libra</b>						
Me 01 Janar 2016	743,780	6,988,740	318,164	5,228,340		13,279,023
Me 31 Dhjetor 2016	730,383	6,483,103	211,544	5,221,006		12,646,036

### Prona, impiantet dhe pajisjet (vazhdim)

<u>Kosto</u>	Ndertesa dhe rruge	Paisje dhe makineri	Mjete transportuese	Paisjet dhe te tjera	Investimet në vijim	Totali
Me 01 Janar 2015	564,286	12,053,678	1,100,841	5,314,801		19,033,606
Blotjet gjate vitit		654,286			257,378	911,664
Transferimet gjate vitit	257,378				(257,378)	0
Shifjet / Hudhjet gjate vitit						0
<b>Me 31.12.2015</b>	<b>821,664</b>	<b>12,707,965</b>	<b>1,100,841</b>	<b>5,314,801</b>		<b>19,945,270</b>
<u>Zhvleresimi i Akumuluar</u>						
Me 01. Janar 2015	(64,487)	(4,994,815)	(676,058)	(79,082)		(5,814,441)
Zhvleresimi I vitit	(13,397)	(724,411)	(106,619)	(7,379)		(851,806)
Rregullimet e lidhura me shifjet/ hudhje						0
<b>Me 31 Dhjetor 2015</b>	<b>(77,884)</b>	<b>(5,719,226)</b>	<b>(782,677)</b>	<b>(86,461)</b>		<b>(6,666,247)</b>
<b>Vlera neto në libra</b>						
<b>Me 01 Janar 2015</b>	<b>499,799</b>	<b>7,058,864</b>	<b>424,783</b>	<b>5,228,123</b>		<b>13,219,165</b>
<b>Me 31 Dhjetor 2015</b>	<b>743,780</b>	<b>6,988,739</b>	<b>318,164</b>	<b>5,220,744</b>		<b>13,279,023</b>

**Trepça – Njësia e administruar në pjesën Jugore të Mitrovicës**  
**Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2016**

**4. Stoqet**

	2016	Me 31 Dhjetor 2015
Stoqet e lëndës së parë dhe materialit	935,013	718,340
Stoqet e gjysëmprodukteve	17,886	12,849
Stoqet e produkteve të gatshme	211,359	849,150
	<b>1,164,258</b>	<b>1,580,339</b>

**5. Llogarite e arkëtueshme**

	2016	Me 31 Dhjetor 2015
<u>Të arkëtueshmet tregtare</u>		
Konsumatorët vendore	1,046,926	584,418
Konsumatorët e huaj	1,032,474	1,015,271
Shlyerja e llogarive të arkëtueshme		(516,106)
	<b>2,079,400</b>	<b>1,083,583</b>
<u>Tjera</u>		
Parapagimi i TVSH-së	2,410,902	1,788,939
	<b>2,410,902</b>	<b>1,788,939</b>
	<b>4,490,302</b>	<b>2,872,522</b>

**6. Paraja dhe ekuivalentet e parasë**

	2016	Me 31 Dhjetor 2015
Llogaritë rrjedhëse me bankat vendore	2,207,643	948,211
Paraja në dorë	1,516	1,303
	<b>2,209,159</b>	<b>949,514</b>

Trepça – Njësia e administruar ne pjesën Jugore të Mitrovicës  
 Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin qe përfundon me 31 Dhjetor 2016

**7. Ekuiteti**

**Kapitali dhe rezervat**

Paraqet deponimet dhe investimet e bëra nga BK qysh nga viti 2001 e deri më sot. Këto deponime janë bërë nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës për investime për ruajtjen e minjierave dhe startimin e punës së tyre.

Rezervat jane njohur si rezultat i vleresimeve te prones, impiante dhe pajimeve.

**8. Detyrimet afatgjata**

	2016	2015
Avancet e marra	1,111,780	68,905
Te hyrat per investime kapitale nga BKK	2,852,533	2,636,862
<b>Me 31 Dhjetor</b>	<b>3,964,313</b>	<b>2,705,767</b>

**9. Llogarite e pagueshme dhe detyrimet tjera**

	2016	Me 31 Dhjetor 2015
<u>Kreditorët Tregtar</u>		
Furnizuesit Vendorë	4,499,514	4,340,969
	<b>4,499,514</b>	<b>4,340,969</b>

**10. Obligimet ndaj te punësuarve**

	2016	Me 31 Dhjetor 2015
Neto pagat te pagueshme	624,811	647,083
Ndalesat per anetarsi sindikale nga neto paga	11,616	23,979
Tatimi ne paga	414,693	358,278
Kontributi per TKPK - punetori	48,486	201,510
Kontributi per TKPK - punedhenesi	48,486	201,510
Ndalesa tjera nga neto paga		71,353
	<b>1,148,093</b>	<b>1,503,713</b>



**Trepça - Njësia e administruar në pjesën Jugore të Mitrovicës**  
**Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2016**

**11. Shitjet**

	Per vitin që përfundon me 31 Dhjetor	
	2016	2015
Te hyrat nga shitja e koncentratit të zinkut	4,691,692	2,314,498
Te hyrat nga shitja e koncentratit të plumbit	9,811,335	5,944,756
Te hyrat nga shitja e aluminiut sulfatit	166,375	142,813
Te hyrat nga shitjet e rimorkiove	1,643	
<b>Total shitjet</b>	<b>14,671,045</b>	<b>8,402,066</b>

**12. Te hyrat tjera**

	Per vitin që përfundon me 31 Dhjetor	
	2016	2015
Te hyrat nga shërbimet për palet të tretë	79,534	272,562
Te hyrat nga qeraja nga ndertesat	83,752	68,197
Te hyrat nga qeraja e paisjeve	183,847	927
Tjera	42,466	700,241
<b>Total shitjet</b>	<b>389,599</b>	<b>1,041,927</b>

**13. Kostoja e stafit**

	Per vitin që përfundon me 31 Dhjetor	
	2016	2015
Pagat e punëtorëve	10,303,676	10,375,477
Kontribute pensionale	518,543	517,537
<b>Total</b>	<b>10,822,219</b>	<b>10,893,014</b>

Trepça - Njësia e administruar në pjesën Jugore të Mitrovicës  
Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2016

**14. Shpenzimet tjera operative**

	Per vitin që përfundon me 31 Dhjetor	
	2016	2015
Mirëmbajtja dhe riparimet	115,786	64,241
Shpenzime tjera administrative	68,181	90,006
Shpenzimet e transportit	258,094	270,091
Shpenzimet e ushqimit të punetoreve	494,812	482,450
Komunalite	118,924	136,564
Stipendionet e punetoreve	299,720	341,332
Shpenzimet e tjera		1,997
<b>Total shpenzimet tjera operative</b>	<b>1,355,519</b>	<b>1,386,681</b>

**15. Te hyrat tjera financiare**

	Per vitin që përfundon me 31 Dhjetor	
	2016	2015
Subvencionet për paga dhe stipendione nga BKK	2,158,009	2,158,009
Mjete të BKK për Investime kapitale	1,118,880	1,039,725
Fitimet nga shkëmbimet valutore	56,634	43,859
Tjera	-	7,960
<b>Total shitjet</b>	<b>3,333,522</b>	<b>3,249,553</b>

**16. Shpenzimet e tatimit në fitim**

Sipas ligjit për të Ardhurat e Korporatave Nr05/L-29 i hyrë në fuqi duke filluar nga Shtatori 2016, Kompania kërkohet të paguaj tatimin mbi të ardhurat në një normë prej 10% mbi fitimin e tatueshëm, siç është llogaritur në Deklaratën vjetore të tatimit në të ardhurat. Kompania ka ka humbje të bartura prandaj nuk ka kalkuar shpenzimin e tatimit në fitim.

## 17. Kontingjentet dhe detyrimet

### Detyrimet tatimore

Librat tatimor dhe regjistrimet e Kompanisë për vitin 2016 nuk janë audituar nga autoriteti i tatimor vendor. Detyrimet e tatimeve të kompanisë nuk mund të konsiderohen të përfunduara. Taksa shtesë që mund të dalin gjatë inspektimit nuk mund të vlerësohen me saktësi.

## 18. Risku i menaxhimit financiar

Menaxhmi i riskut i Kompanisë bartet nga Bordi i Drejtorëve. Menaxhmi i riskut është i fokusuar në pa parashikushmerin e tregjeve dhe mundohet të minimizoj efektet e kundërta mbi performancën biznesore të Kompanisë.

### 18.1 Risku kreditor

Kompania nuk ka koncentrimet domethënëse të riskut kreditor. Maksimumi i ekspozimit të Kompanisë ndaj riskut kreditor prezantohet nga shuma bartëse e secilit mjet financiar në bilancin e gjendjes.

### 18.2 Menaxhimi i riskut kapital

Objektivat e Kompanisë, kur menaxhojn me kapital, janë të ruajnë mundësin që Kompania të vazhdoj vijueshmërinë në mënyrë që të siguroj kthime për aksionaret dhe përfitime për palët tjera të përfshira dhe të mirëmbaj një strukturë optimale të kapitalit që të ulë koston e kapitalit.

Në mënyrë që të mirëmbaj apo rregulloj strukturën e kapitalit, Kompania mund ta risë apo kthej kapitalin të aksionaret apo shes pasurit që ti ulë detyrimet.

### 18.3 Vlerësimi i vlerës reale

Llogarite e arkëtueshme dhe kërkesat tjera të kompanisë, mjetet likuide si dhe detyrimet kanë afat maturimi të shkurtër. Si rrjedhojë e kësaj vlera bartëse korrespondon me vlerën reale të tyre.